



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 172, datë 28.05.2020

**PËR
DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 62, DATË 30.01.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË
GJYQËSOR “PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË PËRKOHSHËM PËR
VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT TË KRITEREVE LIGJORE TË PRANIMIT NË
PROVIMIN E PRANIMIT NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS, PËR VITIN
AKADEMIK 2020-2021 TË KANDIDATËVE PËR KËSHILLTARË DHE NDIHMËS
LIGJORË”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 62, pika 14, neni 85 pika 1 dhe nenin 262 të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 53, nenin 55, pika 1 dhe nenin 56, pika 2 dhe pika 3, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 28, nenin 29, pika 1 dhe në nenin 30 pika 4, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në vendimet nr. 31, datë 23.01.2020 dhe nr.62, datë 30.01.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 62, datë 30.01.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kriterëve Ligjore të pranimit në Provimin e Pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020 – 2021, të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë”, bëhen shtesat e mëposhtme:

1.1 Në pikën 1, pas fjalëve “ndihmës ligjorë” shtohen fjalët si më poshtë:

“... si dhe të japë komente ose kundërshtime për kandidatët për Magjistratë, profili Gjyqtar, që do të pranohen në provimin e Pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020 – 2021.”.

1.2 Në pikën 4, pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Komisioni i Përkohshëm përpilon komentet ose kundërshtimet për kandidatët për Magjistratë, profili Gjyqtar, që do të pranohen në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020 - 2021, duke i propozuar për miratim Këshillit të Lartë Gjyqësor, opinionin mbi listën përkatëse të kandidatëve që plotësojnë kriteret, si dhe listën e atyre që nuk plotësojnë kriteret ”.

1.3 Në pikën 5 pas fjalëve “ndihmës ligjorë” shtohen fjalët si më poshtë:

“... si dhe të japë komente ose kundërshtime për kandidatët për Magjistratë, profili Gjyqtar, ...”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR